



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7504 Prot.

Roskovec, më 31.12 2020

VENDIM

NR 94 .DATË 30.12 .2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN NËNTOR 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 02.12.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Nëntor 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 667/1 Prot.

Roskovec, më 04 . 12 .2020

Procesverbal Nr.10

-I mbajtur sot, date 02.12.2020, ora 13, në mbledhjen e Këshillit të Bashkisë, mbledhje e radhës, me rend dite si më poshtë :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Tetor 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Tetor 2020.
5. Për miratimin e listës emërore të kërkesave shtesë për individë/familje që aplikojnë për cdo program social të strehimit.
6. Për miratimin e projektit me objekt “Ndërtim rruge me rërë bituminoze për varrezat Luar, Qendër.
7. Për miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2021.
8. Për miratimin e Buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe Ndërmarrjeve vartëse si dhe niveli maksimal i pagave për vitin 2021.
9. Për lejimin e vazhdimit të procedurave ligjore të legalizimit të objektit informal të ndodhur në pasurinë Nr.1/240, Roskovec.
10. Për shitjen e pronave të paluajtshme në pronësi të Bashkisë Roskovec, sipas programit “Banesë me kosto të ulët”.
11. Për shpronësimin, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Ndërtim i KUZ, fshati Suk 2”.
12. Për vendosjen e emrave të dëshmorëve të Bashkisë Roskovec, në Memorial.
13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes së mbledhjes: 13⁰⁰

Këshilltaret prezent: A.Kola, V.Mata, E.Çepele, Rr.Hazizi, L.Hoxha, L.Goga, B.Cobo, B.Kuka, D.Hoxha, G.Hoxha, A.Hazizi, A.Sheme, H.Beqiraj, B.Toska, M.Sufka.

Këshilltaret që mungojnë : Kudret Kuka, Tajane Kuka, Kadri Hyska, Vjollca Bakaj, Vera Dogani, Valbona Stani.

Prezent nga administrata e bashkise:Kryetarja e bashkise,nenkryetari M.Goga,Dr.Finances,Dr.Juridike,P/Z.ndihmes/ekonomike,Sp.Urbanistikes,P/Z/tatim-taksave.Prezent kemi edhe disa qytetare.

Me plotesimin e kuorumit,nenkryetari i keshillit Leksi Goga hap mbledhjen.Mbledhja e sotme po drejtohet nga nenkryetari L.Goga,per arsye se kryetarit te keshillit i ka ndodhur nje fatkeqesi dhe nuk do te jete ne mbledhjen e sotme.Prezent ne fillimin e mbledhjes jane 15 keshilltare.Prezent ne mbledhje eshte paraqitur edhe Drejtori i OSHEE-se ne lidhje me shqetesimet e komunitetit dhe te keshilltareve,si dhe kerkesen e banoreve te Vloshit per transformator.Nenkryetari Leksi Goga fillon me mbledhjen.

1.Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimisht me 15 vota pro.

Nenkryetari L.Goga-drejtorit te Oshee-se propozojme tja japim fjalen tani meqe e ka axhenden te ngjeshur dhe duhet te levize,pastaj vazhdojme me rendin sipas radhes.Kryetarja-ne baze te problematikave qe keshilltaret kane ngritur here pas here,drejtori eshte paraqitur sot.Ne do i vem ne djeni edhe ankesat e qytetareve.Dr.Oshee-se sqaron se ne do bejme investim per 4 fshatra ne zonat problematike Kurjan,Mbers,Vlosh,Ngjeqar.Do filloje investimi javen qe vjen.Bujari-problemi i tensionit te larte midis Kumanit dhe Luarit,eshte problem si mund te rregullohet?Dr.Oshee-se sqaron ne lidhje me kete problem,po te ishte e mundur do ishte bere,shpresojme ta stabilizojme dhe realizojme si investim ne 2021.Leksi-kemi pasur ankesa te vazhdueshme,kemi pasur shume shkeputje te energjise ne Roskovec,me orar pa orar,njoftuar pa njoftuar,eshte bere aq stresante sa kur fryne ere ne pergatitemi se mos na ikin dritat.Problemi edhe i ardhjes se tensionit,po na prishen pajisjet elektroshtepiake.Drejtori-me nderhyrjet qe jane bere dhe me nderhyrjet qe do behen besoj se do minimizohen keto probleme.Rrjeti eshte shume i amortizuar.Ka rreth 1 muaj qe eshte stabilizuar Ballshi.Fieri duke ju futur edhe ju eshte nga qytetet qe ka mar me shume investime,ne kemi bere maksimumin.Mateus-ata qe kane matesa te vjeter mendojne se harxhojne me shume se te tjeret,per Vidhishten.Drejtori-do testohen matesat atje ku kane problem dhe do i ndryshojme.Mateus-problemi edhe i mbifaturimit,nuk u jane hequr akoma nga sistemi.Drejtori-do e shikojme.Kryetarja-falenderon drejtorin qe ka ardhur,falenderon per nderhyrjen qe eshte bere ne Kurjan dhe per investimin e 20kv ne Njesine Kurjan qe do te behet,e cila do te jete nje zgjidhje perfundimtare.Roskoveci do te ishte mire te organizohej si Patosi-agjensi me vete,besoj se mund te realizohet.Po te jete me vete do te jete me mire,kemi te njejtet abonente sa Patosi.Drejtori-eshte e veshtire per te ndare nderthurjen e furnizimit,do e bej si test do e ndaj Roskovecin.Kryetarja-te gjendet nje pergjegjes i zones qe te jete me adapt per cdo problem.Kryetarja-problem me disa transformator,lgj.e Likallareve ne Vlosh,kemi nevojte edhe per rritjen e fuqise se transformatorit ne Roskovec.Drejtori-me investimin qe do bejme ne Njesine Kurjan zgjidhet ky problem i tensionit edhe per Vloshin.Kryetarja-ka disa transformator qe jane aktual ku masat e sigurise ne kabine lene shume per te deshiruar,duhet mare masa per sigurine e tyre sepse mund te na ndodhe me e keqja.Drejtori-do i le porosi pergjegjesit,i nxirrni ku jane ju dhe do e zgjidhim.Kryetarja-ne lidhje me ndricimin rrugor,mendoj se ka vjedhje,do i nxjerr linjat dhe do i verifikojme,kerkojme bashkepunimin tuaj.Problemi me i madh eshte furnizimi me energji elektrike dhe stabilizimi.Dorinela-problem me fatura te prambetura,kane ardhur 2 fatura me te njejtin sahat,kam bere ankesa por nuk kam mar zgjidhje per kete problem,ka vite ky problem.Nuk ka me diskutime.Nenkryetari L.Goga falenderon Drejtorin per gadishmerine e treguar dhe shpresojme ne zgjidhjen e problemeve.Keshilltari G.Hoxha largohet.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Tetor 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet e miratuara mbledhjen e kaluar. Nuk kishim asnje vendim normativ. Vendimet e keshillit jane zbardhur dhe u jane shperndare zyrate per zbatim.

3. Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka pyetje. Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

4. Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Tetor 2020.

Elmazi-pyet ne lidhje me 6%, jane hequr disa persona qe kane qene ne liste, dhe jane hequr nga lista e aftesise se kufizuar me arsyen se ka aplikuar per ndihme ekonomike? Elisi-nuk ka lidhje kjo gje, ata i heq vetem komisioni jo ne. Elmazi- cfare kriteresh duhet te plotesojne qytetaret ne 6%? Elisi jep sqarimet sipas ligjit. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

5. Per miratimin e listes emerore te kerkesave shtese per individe/familje qe aplikojne per cdo program social te strehimit.

Elisi-sqaron projekt-vendimin. Gjate muajit Nentor ka pas kerkesa te reja te cilat i kemi sjelle ketu per miratim dhe ti perfshijme ne listen totale te kerkuesve. Aleksander-ka nje afat perfundimtar per aplikime? Elisi-nuk ka afat te fundit. Kryetarja-kerkuesi ne cdo moment paraqitet para bashkise, pastaj varet sipas mundesive meret ne konsiderate edhe kerkesa. Mateus-cilat jane kriteret per te aplikuar? Elisi-ne momentin e pare nuk ka kriteret, ne vleresim po. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

6. Per miratimin e projektit me objekt "Ndertim rruge me rere bituminoze per varrezat Luar, Qender"

Irena-sqaron projektin e ndertimit te rruges per varrezat Luar, Qender. Kjo rruge eshte shume e nevojshme dhe emergjente per keta banore. Kryetarja-nje banor qe eshte afer varrezave e ka zene token me pretendimin se eshte e tij. Kemi bere verifikime dhe qytetari nuk e ka te tijen ate toke, ne do te bejme regjistrimin e asaj rruge dhe me vone do kalojme ne investim. Bujari-ajo pjese e varrezave duhet saktësuar me m², sepse mund te nderhyet, Kryetarja-eshte saktësuar tek regjistri i pronave. Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

7. Per miratimin e Paketes Fiskale per vitin 2021.

P/Z/tatim-taksave Ditmira Dhima sqaron Paketën Fiskale 2021. Cdo ndryshim eshte reflektuar ne Paketën Fiskale te cilat ju i keni miratuar, ka ndryshuar vetem te perjashtimet e takses se tokes, pra vetem toka per fryme perjashtohet. Kryetarja-nuk ka ndryshime ne taksa dhe tarifa, nuk kemi bere rritje duke pare dhe situaten e veshtire te pandemise. Elmazi-Grupi dhe komisioni u mblodh, pame qe nuk kishte ndryshime prandaj mendojme ta kalojme per miratim. Hidhet ne votim projekti i miratimit te Paketes Fiskale per vitin 2021 dhe miratohet unanimit me 14 vota pro.

8. Per miratimin e Buxhetit, numrit maksimal te punonjesve te Bashkise dhe Ndermarrjeve vartese, si dhe niveli maksimal i pagave per vitin 2021.

Bujari-e kam pare materialin dhe jam dakort me buxhetin dhe te gjitha pikat ne vazhdim, kerkon ndjese per tu larguar dhe shpreh voten pro per pikat e rendit ne vazhdim. Selmani-vendimi me i rendesishem i vitit, jemi munduar qe kete buxhet ta bejme me te thjeshte per qytetarin. Sqaron te ardhurat, grandin, shpenzimet e ndara sipas tabelave analitike dhe te detajuara, sqaron numrin e punonjesve te bashkise dhe ndermarrjeve vartese sipas materjalit te paraqitur. Elmazi-ne e kemi pare materjalin ne komision dhe ne grupin e punes, duke pare shperndarjen qe eshte bere ne jemi dakort per ta kaluar. Leksi-dje u bene disa ndryshime te cilat kryetarja do i paraqesi sot. Kryetarja-

edhe ky vit do te jete i ngushtuar persa i takon investimeve,jemi perpjekur te shlyejme borxhet,dhe vitin e ardhshem do hartojme nje buxhet me te gjere ne investime,Kete vit kemi parashikuar blerje materjalesh dhe disa investime te vogla.Ne Marinez do te mbyllim kanal in kullues te shkolla,do bejme trotuar dhe ndricim.Kemi zgjerimin e rruges nga Jagodina ne strum,ne suk 1 do bejme zgjerimin e rruges dhe do ndertojme rrethrotullim,perfundimi i rruges nga Marinza ne Roskovec,jemi futur pjeserisht me nje rruge ne Strum,ne Roskovec kemi rikualifikimin e Parkut me Pisha-Blloku nr.1,kemi nje nderhyrje te vogel tek nje rruge ne Vidhishte dhe Kuman.Ne lagjen e Pirranjakeve do bejme KUZ,do te futemi tek nje rruge lagjja e kooperatives me dakortesine e komisionit dje duke e hequr nga rruga e smt.Kemi parashikuar rikonstruksionin e rruges se lagjes Fushe,ne lagjen Agacaj do asfaltojme segmentin tjeter qe ka ngelur,rikonstruksion i rruges se Kamines dhe Hoxhenj ne Suk.Keto jane nderhyrje modeste te cilat ne i kemi gjykuar si me emergjente,do nderhyjme nga pak ne cdo fshat.Kete vit duhet te shlyejme edhe borxhet qe kemi.Kemi edhe kater rruge varrezash Mbers,Kurjan,Kuman te cilat do i sistemojme.Kemi lene nje fond per rruge parcelash.Investimin per furnizimin me uje per Njesine Strum po e presim nga qeveria,eshte investim shume ambicioz dhe permbush te gjitha nevojat.Kemi projekte qe i kemi cuar ne qeveri dhe presim te na japin miratim nga qeveria.Do te kemi maksimumin e financimit nga qeveria sipas prioritetit qe ata kane.Leksi-per keshillin propozon ti shtohet keshillit 200 mije leke ne buxhetin e tij.Hidhet ne votim projekti me te gjitha ndryshimet e propozuara dhe bere me siper si nga Kryetarja dhe nga Leksi dhe miratohet unanimsht me 14 vota pro Buxheti,numri maksimal i punonjesve te Bashkise,Ndermarrjeve vartese si dhe niveli maksimal i pagave per vitin 2021.

9.Per lejimin e vazhdimit te procedurave ligjore te legalizimit te objektit informal te ndodhur ne pasurine 1/240,Roskovec.

Irena-sqaron projektin e lejimit te vazhdimit te procedurave ligjore te legalizimit te objektit ne pasurine 1/240 Roskovec.Sqaron edhe shkresen e ardhur nga ASHK-ja.Elmazi-eshte prone e bashkise se Roskovecit?Irena-toka eshte e bashkise,objekti eshte i qytetarit.Kryetarja-objekti eshte ne toke te bashkise,ne sot e kemi sistemuar qendren sociale,ne na ka ardhur kerkese nga ASHK per konfirmimin e procesit te legalizimit.Por duke qene se eshte prone publike,vendimin duhet ta merrni ju,po ose jo.Elmazi-keni bere mire qe e keni sjelle ne keshill,jam dakort qe ti jepet drita jeshile atij qytetari,jam dakort te kaloje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimsht me 14 vota pro (3/5+1) sipas materjalit te paraqitur dhe siperfaqes ne planvendosjen perkatese.

10.Per shitjen e pronave te paluajtshme ne pronesi te Bashkise Roskovec,sipas programit “Banese me kosto te ulet”

Delina dr.juridike sqaron projektin e shitjes se apartamenteve pese familjeve sipas prioritetit qe jep ligji dhe emrave qe ju kemi propozuar ne projekt-vendim.Kryetarja-ne morin e kerkesave,kemi edhe kategorine qe kane banuar te banesat e ish pronareve si dhe ato familje qe dalin te pastreha nga rikualifikimi i parkut me pisha,banesat e te cileve do te prishen per shkak te interesit publik.Hapsirat qe jane zene do te merren,gardhet do te prishen.Mendojme ti sistemojme keto pese familje.Hidhet ne votim projekti per shitjen e pronave te paluajtshme ne pronesi te bashkise familjeve te M.Borici,G.Hoxha,R.Çepele,T.Latifi,S.Latifi dhe miratohet unanimsht me 14 vota pro (3/5+1).

11.Per shpronесimin,per interes publik te pasurive te paluajtshme,prone private,qe preken nga projekti “Ndertim i KUZ,fshati Suk 2”

Dr. Juridike sqaron projektin e shpronësimit të qytetarëve që preken nga projekti “Ndertim i KUZ, fshati Suk 2”. Elmazi-keto prona janë marrë me ligjin 7501 apo janë të zaptuara? Delina-jane marrë me ligjin 7501 janë me AMTP. Sipas matjes që ka bërë komisioni në kemi bërë vlerësimin. Hidhet në votim projekti i shpronësimit sipas materialit të paraqitur dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro (3/5+1).

12. Për vendosjen e emrave të deshmorëve të Bashkisë Roskovec, në Memorial.

Dr. Juridike sqaron projektin për vendosjen e emrave të deshmorëve të Bashkisë Roskovec, në Memorial. Prezent kemi edhe kryetarin e organizatës z. Nardi Kushi, i cili falenderon bashkinë për ngritjen e Memorialit. Ata janë deshmorë të shpallur nga Ministria e Mbrojtjes dhe janë të gjithë me statusin e deshmorëve. Lista na ka ardhur nga shoqata dega Fier. Kryetarja-kam një propozim që kerkojë ta hidhni në votë. Ka emra që nuk janë nga Roskoveci por që kanë rënë në Roskovec. Memoriali ka 2 faqe ballore, në një anë do të gdhendim emrat e 1939 deri në momentin kur filloi lufta, pra emrat e të rënëve. Në faqen tjetër të gjithë të rënë gjatë dhe pas luftës nacional-fashiste. Përveç kesaj propozoj që në këtë Memorial të vendosim një pllakadë për ta përmirësuar memorialin, kerkojë që ta miratojmë që ta shtojmë këtë element, pllakadë guri altrarelied. Ky është propozimi im për ta shtuar këtë element. Viktori-atje do shenohen emrat e deshmorëve të luftës antifashiste? Deshmorët janë gjatë luftës jo pas luftës. Kryetarja-ky është memorial jo vetëm për deshmorët e luftës, nuk është vetëm lufta nacional-fashiste por ka edhe luftë të tjera, ky është një memorial për të rënë, pra për të gjithë të rënë. Një faqe emrat deri në 1939, faqja tjetër të rënë nga 1939 dhe në vazhdim. Hidhet në votim projekti bashkë me propozimin që bëri Kryetarja e Bashkisë si më sipër për shtimin e një pllakade guri në memorial dhe miratohet unanimitisht me 14 vota pro projektvendimi për vendosjen e emrave të deshmorëve dhe pllakada në Memorial.

13. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Meti Ngjeqari qytetar-në lidhje me taksat dhe përjashtimin nga taksat vendore të kategorive në nevojë, kerkojë përjashtimin nga taksat vendore për familjet që kanë invalid, para dhe tetraplegjik. Kerkojë të merret parasysh ky propozim. Kryetarja-do shohim efektin financiar me zyrën perkatese dhe do kesh një përgjigje. Viktori-në lidhje me listen e shpronësimeve dhe demshperblimit të banorëve të Marinzes, ka njëzë që nuk e kanë emrin në atë listë, ka njëzë që u është shkatërruar shtëpia dhe nuk e kanë emrin në atë listë. Ka familje që kanë vite skanë ardhur fare aty, jetojnë jashtë dhe marin para. Njerzit janë tepër të revoltuar, nuk e di kush e ka bërë atë listë, nuk është as komision as ekspert, nuk e di kush e ka bërë atë listë. Ai që ka vënë mer leke, ai që është demtuar nuk mer. Si ka mundësi dy veta që i ndan gardhi, njeri e ka emrin tjetri se ka. Agron Pifti e ka shtëpinë 50m nga pusi që shpertheu dhe nuk mori asnjë leke, sot se ka emrin fare, nuk shkon ky muhabet. Kryetarja-keto demshperblime nuk i referohen shperthimit të pusit në Marinez, ato janë bërë nga Bankersi. Kjo ceshtje ka lidhje me lekundjet në vite, jo nga Bankersi, mund të jenë ose nga termeti ose mund të jenë shtuar nga Bankersi. Komisioni ka qenë nga enti i banesave dhe nga aluizni. Sesi e ka bërë vlerësimin komisioni është ceshtje e komisionit. Une jam përpjekur që ta marrë këtë demshperblim nga qeveria, vlerësimin e ka bërë komisioni, në jemi të detyruar që ta zbatojmë vendimin e qeverisë. Në jemi të hapur për ankesa të qytetarëve si për vlerën edhe për rastin kur se kanë emrin, une do i administrojë vetë keto ankesa. Viktori-pse keto padrejtesi behen vetëm për Marinzen? Kryetarja-eshtë në cdo fshat. Aleksander-për sistemin e ngrohjes në shkollën e fshatit Suk 2, çfare mund të bëhet për kaldajat? Tek lagjja ime neonet janë djegur të gjitha. Kryetarja-duhej tja kishe bërë këtë ankesë drejtorit e oshee-se. Alketi-edhe në lagjen time janë djegur neonet, i kam thënë Renatos disa here. Alketi-problem në rrugën e lagjes time në lidhje

me punimet e firmes per ujesjellesin,kanalet i kane lene hapur,asfaltin nuk e kane bere ne cilesine e duhur,po ankohen banoret.Nuk ka me diskutime.Nenkryetari Leksi Goga mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

Në mungesë dhe me porosi

Zëvendëskyetar

Leksi Goga

